

GJUHË SHQIPE

(GJUHË E BASHKËSIVE)

Materiale mësimore për klasën VII



PËRMBAJTJA

PËRDITSHMËRIA IME NË MJEDISIN KU MËSOJ, KU JETOJ DHE KU SHOQËROHEM

a) Modelet e komunikimit

Kush jam unë

Karakteristikat (tiparet) e mia

Unë jam unik/e në ...

Modelet dhe personat që i admiroj (muzikantë, sportistë, shkrimtarë dhe shkencëtarë)

Unë në familjen time, unë dhe/me të tjerët

Unë në shkollë

Plani im ditor për mësim dhe argëtim

Kontributi im në shkollë

b) Njësitë leksikore

Emrat

Mbiemrat

Foljet

Ndajfoljet

Lidhëzat dhe parafjalët

Fjalët dhe shprehjet pyetëse

c) Strukturat gramatikore

Fonetika dhe drejtshqiptimi

Shqiptimi i drejtë i bashkëtingelloreve

Ndërrimet fonetike

Theksi në gjuhën standarde shqipe

Morfologjia

Emrat

Mbiemrat

Përemrat

Foljet

Lidhëzat dhe parafjalët

Sintaksa

Fjalja e thjeshtë

ç) Të lexuarit dhe të shkruarit

Dëgojmë, lexojmë dhe shkruajmë

d) Tema për diskutim

Respekt për të gjithë në shkollë

Ndërkombëtarizmat dhe ballkanizmat

a) Modelet e komunikimit

Kush jam unë?

Unë jam Ela, jam
nxënëse.



Standardet për vlerësim:

- Shqipton saktë fjalët e reja dhe i përdor në kontekste të përshtatshme

Unë jam Mateo,
jam sportist.



Unë jam Sara, jam
matematikane



Unë jam Darisi, jam
korist në korin e shkollës.



Unë jam Suzi, jam
valltare



Unë jam Beni, jam një
kopshtar i vogël.



AKTIVITET

Nxënësit ndahen në çifte. Lexojnë prezantimet e nxënësve në foto në formë dialogu duke i shqiptuar saktë fjalët e reja. Më pas i zëvendësojnë ato me profesione të tjera (p.sh. piktor/e, këngëtar/e, recitues/e, basketbollist/e etj.)

PËRDITSHMËRIA IME NË MJEDISIN KU MËSOJ, KU JETOJ DHE KU SHOQËROHEM

a) Modelet e komunikimit

Karakteristikat e mia

Unë jam Ela, jam nxënëse shembullore, lënda ime e preferuar është gjuha shqipe.



Standardet për vlerësim:

- Prezanton saktë veten duke përdorur modele të shkurtra gjuhësore, shprehje të sakta gjuhësore dhe i tregon arritjet dhe sukseset e veta pozitive.

Unë jam Mateo, jam një sportist i dalluar dhe luaj futboll me shokët e lagjes.



Unë jam Sara, e dua matematikën dhe jam shumë e shoqërueshme.



Unë jam Darisi, jam korist në korin e shkollës. Jam i singertë kur këndojmë së bashku për festa.



Unë jam Suzi, jam një valltare dhe vallzoj me pasion



Unë jam Beni, jam një kopshtar i vogël i dua lulet dhe jam i kuidesshëm me ato.



AKTIVITET

Nxënësit ndahen në grupe. Çdo nxënësi i jepet një fletë prej letre. Mësimdhënësi/ja jep udhëzimin: “Secili duhet të mendojë dhe të kujtojë diçka që ka bërë ose ka arritur dhe që e dallon nga bashkëmoshatarët e vet – diçka që e bën atë të veçantë në krahasim me të tjerët (p.sh. *unë di të lexoj shkronjat me kokë poshtë; unë di të zgjidh kubin e Rubiku; unë fitova ping pong në konkursin e qytetit*)”.

Brenda grupit, nxënësit shkëmbejnë “veçantitë” e tyre dhe bien dakord se kush kë do të përfaqësojë përballë të tjerëve, duke u shprehur me një fjali unike. Ata shkruajnë veçantinë e personit që duhet të përfaqësojnë në një fletë prej letre dhe e lexojnë atë para të gjithë nxënësve të klasës. Nxënësit e tjerë përcaktojnë se kujt i referohet veçantia.

PËRDITSHMËRIA IME NË MJEDISIN KU MËSOJ, KU JETOJ DHE KU SHOQËROHEM

a) Modelet e komunikimit

Unë jam unik/e në ...



DETYRË

Lidh me shigjetë profesionet e personazheve me shprehjet përkatëse dhe shqiptoi saktë fjalitë e dhëna!



Unë jam Ela, jam nxënëse shembullore, lënda ime e preferuar është gjuha shqipe.

Jam unike në zgjidhjen e problemeve.



Unë jam Mateo, jam një sportist i dalluar dhe luaj futboll me shokët e lagjes.

Kam fituar çmimin për lexim të mirë tri herë.



Unë jam Darisi, jam korist në korin e shkollës. Jam i sinqertë kur këndojmë së bashku për festa.

Jam unike në skenë.



Unë jam Sara, e dua matematikën dhe jam shumë e shoqërueshme.

Jam lojtari i mirë dhe unik në gjuajtje.



Unë jam Suzi, jam një valtare dhe vallzoj me pasion.

Kam zërin unik.



Unë jam Beni, jam një kopshtar i vogël i dua lulet dhe jam i kujdesshëm me to.

Jam unik në njohjen e llojeve bimore.



AKTIVITET

Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë fjalën “unike”. Secili individualisht mendon se çfarë i bën ata unik në krahasim me të tjerët në klasë. Mund të bëhet fjalë për pamjen, diçka që lidhet me familjen (të jesh binjak, të kesh 4 vëllezër etj.), hobi, lojërat e preferuara etj. Nxënësit identifikojnë tri gjëra që i bëjnë ata unikë.

a) Modelet e komunikimit

Modelet dhe personat që i admiroj

Në jetën time kam shumë persona që i admiroj. Disa prej tyre janë të njohur në gjithë botën, të tjerët janë personazhe nga libra apo filma.



Njëra prej tyre është **Marie Curie**, një shkencërate e njohur në tërë botën që punoi shumë për të zbuluar elemente të rëndësishme siç është radiumi. Ajo ishte gruaja e parë që fitoi çmimin Nobel dhe nuk u ndal kurrë së kërkuari dije, edhe kur përballlej me vështirësi.



Një tjetër që më pëlqen shumë është **Beethoven**, një muzikant i madh që krijoi muzikë të mrekullueshme edhe pse nuk dëgjonte. Ai më meson që asgjë nuk është e pamundur kur e do me shpirt punën që bën.



Gjithashtu, më pëlqen personazhi **Harry Potter** nga libri me të njejtin emër. Ai është trim, i drejtë dhe gjithmonë lufton për të mirën edhe kur është në rrezik.

Të gjithë këta persona më motivojnë të jem i/e mirë, të mos dorëzohem dhe të ndjek ëndrrat e mia.

Standardet për vlerësim:

- Përdor shprehje të përshtatshme për t'i treguar personat që i admiron dhe shembuj që i ndjek dhe i adhuron tek ata.
- Numëron saktë karakteristikat (tiparet) e një personi tjetër (të famshëm).



DETYRË

Lexo tekstin dhe përgjiu!

- Pse është për t'u admiruar Marie Curie?
- Cila është veçantia e Beethoven?
- Po ti a e admiron Harry Potter? Pse?



AKTIVITET

Nxënësit sjellin materiale me foto apo vizime të ndryshme përmes së cilëve prezantojnë dikë që e adhurojnë, që është idhulli i tyre etj. Duke e paraqitur personin para të tjerëve, ata përdorin mbiemra që japin tiparet e karakterit dhe arritjet e personit në fjalë.

a) Modelet e komunikimit

Unë në familjen time



Standardet për vlerësim:

- Pyet dhe u përgjigjet pyetjeve që kanë të bëjnë me sjelljen e vet/personale, sjelljen e/ndaj prindërve/shokëve/mësimdhënësve.
- Tregon mënyra të ndryshme për pjesëmarrje aktive në jetën familjare.

Familja ime është vendi ku ndjehem më i/e sigurtë dhe më i/e lumtur. Në familjen time jemi pesë anëtarë: prindërit, motra ime, vëllai dhe unë. Ne kalojmë shumë kohë së bashku dhe kujdesemi për njëri-tjetrin.

Edhe pse jam ende fëmijë, unë përpiqem të ndihmoj sa më shumë në shtëpi. Çdo ditë, pas shkollës, pastroj dhomën dhe i ndihmoj nënës në kuzhinë. Të dielave, shpesh fshij oborrin ose i ndihmoj babait në punët e kopshtit.

Kur dikush nga familja ime ka nevojë për ndihmë, përpiqem të jem pranë tij. Pjesëmarrja ime në jetën familjare më bën të ndihem i/e rëndësishëm/me dhe më mëson të jem i/e përgjegjshëm/me.

Unë besoj se çdo anëtar i familjes ka një rol të rëndësishëm. Kur bashkëpunojmë dhe kujdesemi për njëri-tjetrin, familja jonë bëhet më e fortë dhe më e lumtur.

Unë me të tjerët



Unë jam një fëmijë që e dua shoqërinë dhe miqtë. Më pëlqen të luaj, të mësoj dhe të ndaj kohën me të tjerët. Besoj se secili prej nesh është i veçantë dhe i rëndësishëm në mënyrën e vet.

Kur jam me të tjerët, përpiqem të jem i/e sjellshëm/me dhe i/e kuptueshëm/me. Dëgjoj me vëmendje, ndihmoj kur dikush ka nevojë dhe mundohem të mos lëndoj askënd me fjalë apo vepra. Shoqëria është më e bukur kur sillemi mire me njëri-tjetrin.

Në klasë bashkëpunoj me shokët dhe shoqet. Respektoj mendimet e tyre edhe kur janë të ndryshme nga të miat. Në lagje dhe në familje, përpiqem të jem një shembull i mirë.

Kam mësuar se të jetosh me të tjerët do të thotë të jesh i drejtë, i dashur dhe i sjellshëm. Vetëm kështu mund të ndërtojmë një botë të ndërtuamë një botë më të mirë për të gjithë.



DETYRË

Pyetje për diskutim!

- A ndihmon prindërit në shtëpi? Në çfarë mënyre?
- Si sillesh kur nuk je dakord me prindërit?
- Cili është momenti më i bukur që ke kaluar me familjen?
- A i ndihmon shokët/shoqet kur kanë vështirësi në mësimet ose në lojë?
- A i respekton të tjerët edhe kur janë të ndryshëm nga ty?
- Çfarë bën kur sheh dikë të vetëm apo të mërzhitur?
- A e dëgjon me kujdes mësuesin/sen kur ata flasin në orë/
- A respekton rregullat që mësuesi/sja vendos në klasë/
- Çfarë do të bëje për të treguar se i respekton dhe i vlerëson mësuesit/et?



AKTIVITET

Nxënësit ndahen në grupe me nga katër veta, dhe secilit nxënësi i jepet një kopje e fletës së punës në të cilën duhet të vendosin aktivitetet e preferuara që ka bërë me ndonjë anëtarë të familjes tre vjet më parë dhe ndonjë aktivitet që kryen tani. (p.sh. *dikur doja të luaja shah, tani dua të eci buzë lumit*). Ata duhet të zgjedhin tre anëtarë të familjes që mund të jenë të afërm ose të largët. Puna paraqitet para gjithë klasës.

a) Modelet e komunikimit

Unë në shkollë



Standardet për vlerësim:

- Dëgjon, kupton dhe u përgjigjet pyetjeve/informacioneve që lidhen me jetën shkollore.
- Paraqet orarin e vet të orëve mësimore sipas lëndëve dhe sipas numrit të orëve.
- Numëron lëndët e preferuara dhe jep shpjegime të shkurtra për to.

Marini: Përshëndetje, Ana! E kontrollove orarin e ri të orëve mësimore?

Ana: Po! Pashë që nesër kemi kimi në orën e parë dhe fizikë në orën e tretë. Dy lëndë të reja sivjet. Do të jetë një ditë e ngarkuar!

Marini: E di! Por më pëlqejnë të dyja lëndët, veçanërisht fizika. Mësuesi dje foli për forcat dhe na tregoi një eksperiment me magnet. Ishte shumë zbavitëse!

Ana: Po, interesante! Edhe në kimi më pëqeu mësimi për përbërjen e ujit, mësuesja e shpjegoi shumë bukur.

Marini: Po! Më pëlqen kur mësuesit i shoqërojnë mësimet me shembuj praktikë. Mësohet më lehtë ashtu.

Ana: Edhe mua më pëlqen. Duhet të përpiqemi të mos mbetemi mbrapa. A e ke mbaruar detyrën e kimisë?

Marini: Po e mbarova mbrëmë. Mund të ta tregoj në pushim nëse do.

Ana: Faleminderit Marin, je shok shumë i mirë! Hajde tani, të mos vonohemi për orën e parë!



DETYRË

Pyetje për diskutim!

- Sa lëndë mësimore keni këtë vit?
- Cila është lënda yte e preferuar?
- Shpjego arsyet përse pikërisht e pëlqen atë lëndë!
- Ke ndonjë lëndë që s'të pëlqen?
- Cila nga lëndët mësimore të duket më e rëndë për ta përvetësuar dhe pse?



AKTIVITET

Nxënësit shkruajnë në mënyrë të pavarur orarin e mësimit dhe e prezantojnë atë përpara të gjithëve në klasë.

	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					

PËRDITSHMËRIA IME NË MJEDISIN KU MËSOJ, KU JETOJ DHE KU SHOQËROHEM

a) Modelet e komunikimit

Unë në shkollë



Standardet për vlerësim:

- Harton thënie për përgjegjësitë e tij/saj shkollore.
- Parashtron pyetje lidhur me detyrimet e shkollës.
- U përgjigjet pyetjeve në lidhje me shkollën dhe përgjegjësitë e saj.
- Inicon dhe merr pjesë në dialogë, në të cilët shprehet për përgjegjësitë që ka në shkollë, për oraret dhe për lëndët.

Shkolla nuk është vetëm vendi ku mësojmë njohuri të reja. Ajo është gjithashtu një vend ku mësojmë sit ë sillemi mire, sit ë respektojmë të tjerët dhe sit ë jemi të përgjegjshëm për veprimet tona.

Si nxënës, unë kam disa detyrime dhe përgjegjësi që duhet t'i përmbush çdo ditë:

- Të vij në shkollë me kohë dhe i/e përgatitur me libra dhe me mjete të nevojshme.
- Të dëgjoj dhe të respektoj mësuesit.
- Të jem i/e sjellshëm/e me shokët dhe shoqet e klasës.
- Të mos e ngacmoj askënd.
- Të bëj detyrat e shtëpisë në kohë dhe me përkushtim.
- Të kujdesem për pastërtinë e klasës dhe të ruaj pajisjet shkollore.
- Të marr pjesë rregullisht në orët e mësimi dhe të përpiqem të mësoj çdo ditë diçka të re.
- Të ndihmoj shokët dhe shoqet kur ato kanë vështirësi në mësim.

Kur respektoj këto detyra, unë tregoj se jam një nxënës/e i/e mirë dhe një qytetar/e i/e përgjegjshëm/e. Shkolla bëhet një vend më i bukur kur të gjithë punojmë së bashku dhe sillemi si duhet.



DETYRË

Lexo me kujdes tekstin dhe përpiqu të hartosh pyetje për shokët/shoqet e klasës për përgjegjësit dhe detyrimet tuaja shkollore!



AKTIVITET

Nxënësit lexojnë një listë të detyrave të shkollës, zgjedhin një që u pëlqen dhe një që e kryejnë sepse është e detyrueshme.

Secili nxënës bën një prezantim para klasës për përgjegjësitë ditore.

PËRDITSHMËRIA IME NË MJEDISIN KU MËSOJ, KU JETOJ DHE KU SHOQËROHEM

a) Modelet e komunikimit

Unë në shkollë

Standardet për vlerësim:

- Harton thënie me fjalorin e duhur duke përdorur trajtat e duhura të foljeve të vetës për kohën e tashme dhe për të kryerën e thjeshtë.
- Përdor thënie duke përdorur në mënyrën e duhur fjalët pyetëse në fjalitë pyetëse (*a, nëse, çfarë, kush, çka*).
- Përdor fjali duke përdorur saktë ndajfoljet të kohës, numërorët dhe përemrat dëftorë e pronorë.

Ushtrime dhe detyra

1. Hartoni pesë fjali me trajtat e duhura të foljeve:

kemi, mësoj, shkruajmë, bëme, kënduan!

2. Vendos fjalët pyetëse: *A? Çfarë? Kush? Çka?* para çdo fjalie përkatëse:

_____ mësuam sot në gjuhën shqipe?
_____ të pëlqen të bësh në shkollë?
_____ është shoku yt më i mirë?
_____ ke nevojë për ndihmë?

3. Cila nga këto fjalë tregon kohë? Cila nga këto fjalë tregon përemër? Cila nga këto fjalë tregon numër?

- a) Shkolla
- b) Sot
- c) Bukur
- ç) Luaj

- a) Darkë
- b) Klasë
- c) Kujdesem
- ç) Unë

- a) Dy
- b) Asnjëherë
- c) Lexova
- ç) Libri

Tani përdor përgjigjet e sakta dhe krijo një fjali!

PËRDITSHMËRIA IME NË MJEDISIN KU MËSOJ, KU JETOJ DHE KU SHOQËROHEM

a) Modelet e komunikimit

Plani im ditor për mësim dhe argëtim

Standardet për vlerësim:

- Përdor thënie në të cilat i tregon aktivitetet e tij të përditshme.



Zgjahem në orën 07:00 çdo mëngjes.



Deri në orën 07:30 bëj përgatitjet e mëngjesit.



Orët mësimore më fillojnë në ora 08:00.



Në orën 14:00 kur kthehem nga shkolla pushoj pak dhe shkoj në kurs të aktrimit.



Të shtunën dhe të dielën nga ora 12:00 deri në orën 17:00 argëtohem me shokët dhe shoqet e lagjes. Ndërsa kohën tjetër ia kushtoj mësimëve.



AKTIVITET

Secili nxënës bën një prezantim para klasës për planin e tij ditor.

a) Modelet e komunikimit

Kontributi im në shkollë



Standardet për vlerësim:

- Arsyeton si duhet të duket shkolla e tij sipas vizatimit të bërë ose sipas animacionit kompjuterik.
- Tregon arsyet pse dëshiron/mund të bëjë gjëra të caktuara ose nuk dëshiron/nuk mund t'i bëjë ato.
- Prezanton planet e tij/saj për iniciativat e nxënësve.

Shkolla është vendi ku unë mësoj, rritem çdo ditë dhe kaloj kohën më të madhe me shokët, shoqet dhe mësuesit. Shkolla duhet të jetë një vend i pastër, i sigurt dhe i gëzueshëm për të gjithë nxënësit.

Dua që shkolla ime të ketë mure të bukura dhe me ngjyra, klasa të rregullta dhe të ndriçuara mirë. Në çdo klasë duhet të ketë libra, mjete mësimore dhe kënde leximi për të nxitur dashurinë për dijen. Oborri shkollës duhet të jetë i gjelbër, me lule dhe pemë, ku mund të pushojmë gjatë pushimeve.

Shkolla ime duhet të jetë një vend ku të gjithë të ndihen të barabartë, ku ka respekt dhe bashkëpunim. Mësuesit duhet të jenë të duruar dhe të dashur, ndërsa nxënësit të sjellshëm dhe të zellshëm.

Secili nga ne duhet të kujdeset dhe të jep kontributin e tij, që shkolla të bëhet një vend më i bukur dhe më i dashur për të gjithë. Një shkollë e tillë më bën të ndihem mirë dhe më shtyn të mësoj me dëshirë çdo ditë.



AKTIVITET

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grupi i jepet një detyrë e ndryshme: Grup i parë – *Çfarë mund të kontribuojë secili prej jush individualisht në zbulimin e klasës?* Grupi i dytë – *Çfarë mund të bëjë secili prej jush për shfaqjet dhe garat për t'i bërë ato më tërheqëse?* Grupi i tretë – *Çfarë mund të bëjë secili prej jush për ta bërë oborrin e shkollës një vend të pastër dhe të sigurt për qëndrimin e nxënësve?* Secili grup duhet të mendojë dhe të shkruajë ose të vizatojë në një fletë të madhe letre disa gjëra që secili prej tyre mund të bëjë për ta bërë shkollën një vend më të këndshëm për të qëndruar dhe mësuar. Më pas një nxënës nga secili grup prezanton detyrën.

a) Modelet e komunikimit

**Kontributi im në
shkollë**



AKTIVITET

Nxënësit punojnë në çifte. Secili nxënës në çift thotë: *Unë mundem... Unë dua...* Fjalitë i referohen kontributit që nxënësit mund të bëjnë për shkollën.

Standardet për vlerësim:

- Kupton dhe komenton shkurt pyetjen e parashtruar për temën e dhënë.
- Pyet dhe u përgjigjet pyetjeve që lidhen me ngritjen e cilësisë së jetës në shkollë dhe në shtëpi.
- Nxit ose përfshihet në një dialog ose bisedë të shkurtër lidhur me secilën nga njësitë tematiko-komunikuese.



DETYRË

Diskuto rreth aktivitetit:

- Si e sheh ti shkollën tënde?
- Çfarë dëshiron të ndryshosh në shkollë?
- Çfatë mund të bësh ti, që të ndryshosh diçka në shkollë?
- Trego një rast kur ke kontribuar në shkollë dhe trego si u ndjeve!
- Çfarë dëshiron të ndryshosh në shkollën tënde, por që nuk mund ta bësh atë?
- Çfarë kontributi do të jepje po të organizoheshin gara sportive në shkollën tuaj?
- Nëse një shok apo shoqe ka nevojë për ndihmë rreth mësimave, si do të veproje?

b) Njësitë leksikore

Emrat

Ushtrime dhe detyra

1. Shqiptoni drejt emrat dhe përktheni ato në gjuhën tuaj amtare!

- *admirim, kreativitet, origjinalitet, interes, dëshirë, liri, veprimtari, shkathtësi, bashkëpunim, shoqërim, besim, vetëbesim;*
- *basketboll, futboll, shah, muzikë, seksion, stacion i transmetimit;*
- *respekt, besim, dashuri, ndryshim, krahasim, shok, nevojë, mbështetje, komunikim, rrethanë, shprehi, situatë, pakënaqësi,*

Standardet për vlerësim:

- Përdor emrat e mësuar që tregojnë interesat, mundësitë, veprimet dhe tiparet të tij/saj dhe tipare karakteri në situata të reja shkollore dhe familjare.
- Lidh saktë afinitetet e veta me aktivitetet që rrjedhin nga përmbajtjet programore në shkollën e tij/saj.
- Emërton dhe numëron aktivitetet e lira të nxënësve që realizohen në shkollën e tij/saj.

2. Plotëso fjalitë me emrat e duhur:

(Përdor fjalët: *interes, dëshirë, shkathtësi, besim, bashkëpunim, vetëbesim, kreativitet, origjinalitet, liri, veprimtari, admirimi, shoqërim*)

- a) Kam shumë _____ për të mësuar lëndët që më pëlqejnë.
- b) Në aktivitete të lira, tregoj _____ dhe ndihmoj shokët e klasës.
- c) Gjatë lojërave në shkollë, tregoj _____ dhe sjell ide të reja.
- ç) Marr pjesë në _____ të ndryshme jashtë orarit mësimor.
- d) Kam _____ të madh për njerëzit që punojnë me pasion.
- dh) Më pëlqen të kem _____ për të shprehur mendimin tim.
- e) Kam _____ kur flas para klasës dhe ndaj idetë e mia.
- ë) Shoqëria në shkollë më jep ndjenjën e _____ dhe mbështetje.
- f) Në punë në grup, tregoj _____ dhe respektoj të tjerët.
- g) Ideja ime ishte e mbushur me _____ dhe u pranua nga të gjithë.



AKTIVITET

Nxënësit ndahen në grupe, emërtojnë dhe numërojnë aktivitetet e lira të nxënësve që ofrohen në shkollën e tyre.

b) Njësitë leksikore

Mbiemrat



Standardet për vlerësim:

- Tregon ngjarjet më të rëndësishme në familje dhe në shkollë, duke përdorur emra të përveçëm dhe mbiemra cilësorë.
- Lidh saktë karakteristikat e personalitetit të nxënësit në shtëpi dhe në shkollë, duke përdorur emra të përgjithshëm, të përveçëm, emra abstraktë dhe mbiemra cilësorë.

Në familjen Berisha, fundjava e kaluar ishte një nga ato ditët që mbeten gjatë në kujtesë. Beni, djali i tyre i vetëm, mori një çmimin për pikturën më të mirë në konkursin e organizuar nga shkolla. Gëzimi dhe krenaria mbushën shtëpinë. Prindërit u emocionuan shumë, sepse për ata suksesi i djalit të tyre ishte një shpërblim për përkushtimin dhe dashurinë që kishin dhënë gjithmonë. Atmosfera në shtëpi ishte e qetë dhe e këndshme, ndërsa Beni, i kënaqur dhe plot vetëbesim, e ndau çmimin me të gjithë.

Në shkollën "Liria", Beni është një nxënës i respektuar dhe shumë i dashur. Ai është gjithmonë i qetë, i sigurt në vete dhe i vendosur në gjithçka që bën. Mësuesja e artit, shpesh e përmend si shembull për nxënësit e tjerë. Beni është krijues, plot ide interesante dhe gjithmonë gjen mënyra të veçanta për të shprehur ndjenjat e tij përmes vizatimeve. Ai ka një interes të thellë për artin dhe natyrën, dhe kjo e bën të jetë një djalë interesant dhe i veçantë.

Karakteristikat e tij të personalitetit, si vendosmëria, siguria në vete dhe respekti për të tjerët, shfaqen qartë si në shtëpi, ashtu edhe në shkollë. Ai është një shembull i një nxënësi të aftë, që di të ruajë ekuilibrin midis përkushtimit ndaj mësimave dhe pasioneve personale.



DETYRË

Lexoni me kujdes tekstin, nënvizoni emrat dhe mbiemrat dhe më pas shënoni ato në kolonat përkatëse të dhëna në tabelë!

Emrat	Mbiemrat



AKTIVITET

Nxënësit marrin pjesë në një diskutim në të cilin rendisin ngjarjet më të rëndësishme në familje dhe në shkollë, duke përdorur emrat e duhur dhe mbiemrat përshkrues.

b) Njësitë leksikore

Foljet

Fjalët e shënuara me **të zezë** janë **folje**:

1. Agimi gjithmonë **respektonte** rregullat e shkollës.
2. Ema **vendosi** të ndihmonte shoqen.
3. Denisi gjithmonë **kërkonte** ndihmë kur nuk **kuptonte** diçka.
4. Arta i **dha** një libër shokut të saj.
5. Nxënësja **zgjidhi** ushtrimin pa ndihmë.

Standardet për vlerësim:

- Ndërton fjali/ shprehje të shkurtra duke përdorur folje në të pakryerën dhe të kryerën e thjeshtë në kontekstin përkatës.
- Përdor trajtat e përemrave dëftorë dhe vetvetorë në shprehje të shkurtra me emra të mësuar.



DETYRË

Plotëso fjalitë më poshtë me foljen e duhur në kohën e pakryer ose të kryer të thjeshtë!

1. Dje, Martini _____ (vepron) me guxim.
2. Ana gjithmonë _____ (respekton) të rriturit.
3. Kur ishte më i vogël, Adisi _____ (frikësohet) nga zëri i fortë.
4. Nxënësit _____ (kërkon) falje për sjelljen e tyre.
5. Mbrëmë, Azra _____ (komenton) para klasës një film edukativ.
6. Danieli _____ (beson) tek miqtë e tij më të ngushtë.
7. Nxënësit _____ (zgjedh) të shkonin në ekskursion.
8. Gjatë mësimit, Nina _____ (interesohet) shumë për temën.



DETYRË

Përdorni trajtat e përemrave dëftorë në vend të emrave në kllapa!

1. (Nxënësit) _____ i pëlqejnë eksperimentet në shkollë.
2. T'ju prezantoj me Sarën. (Sara) _____ është shoqja ime e bankës.
3. (Nadja) _____ është nxënëse e shkëlqyeshme.
4. (Toni) _____ ndihmon shumë në shkollë.
5. (Vajzat) _____ këndojë shumë bukur.



AKTIVITET

Nxënësve u jepet një listë me dy kolona foljesh: folje në kohën e pakryer dhe folje në kohën e kryer të thjeshtë. Ata vendosin çdo folje në një fjali të veçantë duke e përdorur atë pikërisht sipas kontekstit.

b) Njësitë leksikore

Ndajfoljet

Ndajfoljet janë fjalë që plotësojnë para së gjithash foljen, duke treguar mënyrë, vend, kohë, shkak, qëllim, sasi.

Fjalët e shënuara me **të zezë** janë **ndajfolje**:

1. Vera e Doriani silleshin **mirë** me të gjithë.
2. Të gjithë ishin mbledhur **afër** shkollës.
3. Erdha **sot** nga Shkupi.
4. **Pse** nuk mëson edhe ti si të tjerët?
5. Kam vizituar **tri herë** teatrin.

Ushtrime dhe detyra

Ushtrimi 1: Zgjidh ndajfoljen në fjali

Udhëzim: Nënvizoj fjalën që tregon si, ku, ose kur ndodh veprimi!

1. Ai flet shpejt.
2. Ne jetojmë këtu.
3. Ajo punon mirë.
4. Shkoj në shkollë herët.
5. Fëmijët luajnë jashtë.

Ushtrimi 2: Plotëso fjalitë me një ndajfolje të përshtatshme!

Udhëzim: Zgjidh një ndajfolje për të përfunduar fjalinë! (Shkruaje vetë ose zgjidh nga lista: *ngadalë, aty, nesër, mirë, larg*)

1. Unë do të vij _____.
2. Ai ecën _____.
3. Ne jemi _____.
4. Mësuesja flet shumë _____.
5. Ata banojnë _____ nga qyteti.

Ushtrimi 3: Lidh fjalitë me ndajfoljen e duhur!

Udhëzim: Bashko pjesët e fjalisë duke përdorur një ndajfolje të përshtatshme!

Fillimi i fjalisë	Zgjidh një ndajfolje për ta përfunduar
Ajo vallëzon	(shumë bukur / ngadalë / keq)
Ne do të takohemi	(nesër / sot / më vonë)
Libri është	(këtu / atje / sipër)
Ai flet	(qartë / shpejt / me zë të ulët)

Ushtrimi 4: Gjej ndajfoljet në tekstin më poshtë!

Udhëzim: Lexo tekstin dhe nënvizo të gjitha ndajfoljet!

Sot, Ana shkoi herët në shkollë. Ajo ecën ngadalë, sepse rruga është me borë. Në klasë, ajo flet qartë me shoqet dhe mëson mirë.

Ushtrimi 5: Krijo fjali vetë!

Udhëzim: Përdor një nga këto ndajfolje në një fjali tënde: *shpejt, tani, këtu, mirë, lart!*

1. _____
2. _____
3. _____

b) Njësitë leksikore

**Lidhëzat dhe
parafjalët**

Standardet për vlerësim:

- Ndërton fjali të shkurtra me lidhëza dhe parafjalë (*dhe, edhe, ose, kurse, por; në, nën, mbi, nga për, përmbi, mes...*)

Lidhësa janë: *dhe, edhe, ose, kurse, po, por, apo, as, kurse, mirëpo, ndërsa, prandaj etj.*

Parafjalë janë: *në, nën, mbi, nga, te, tek, për, prej, përmbi, mes, ndaj etj.*

Ushtrime dhe detyra

Ushtrimi 1: Plotëso fjalinë me lidhëzën e duhur!

Udhëzim: Zgjidh një nga këto lidhëza: *dhe, edhe, ose, kurse, por, prandaj, sepse!*

1. Ana ka një vëlla _____ një motër.
2. Dritarja është hapur, _____ dera është e mbyllur.
3. Do të shkoj në park _____ do të rri në shtëpi.
4. Kam uri, _____ nuk kam kohë për të ngrënë.
5. Mësova shumë, _____ mora notë të mirë.
6. Ai nuk erdhi, _____ ishte i sëmurë.
7. Sara lexon libra, _____ pëlqen të shkruajë tregime.

Ushtrimi 2: Plotëso fjalinë me parafjalën e duhur!

Udhëzim: Zgjidh një nga këto parafjalë: *në, nën, mbi, nga, për, përmbi, mes!*

1. Libri është _____ tryezë.
2. Ma solli dhuratën _____ Italia.
3. Fëmijët luajnë _____ pemë.
4. Topi është fshehur _____ karrige.
5. Kjo është një dhuratë _____ ty.
6. Ora është vendosur _____ murit.
7. Ai u ul _____ dy shokëve të tij.

Ushtrimi 3: Bashko fjalitë me një lidhëz të përshtatshme!

Udhëzim: Zgjidh një nga këto lidhëza: *dhe, por, ose, kurse, sepse, prandaj!*

1. Më pëlqejnë mollët. Nuk më pëlqejnë dardhat.

→ _____

2. Dua të shkoj në kinema. Jam shumë i lodhur.

→ _____

3. Ai është i sjellshëm. Të gjithë e duan.

→ _____

4. Ke dy mundësi. Shkruaj ose vizato.

→ _____

Ushtrimi 4: Krijë një fjali të shkurtër duke përdorur fjalët e dhëna!

Shembull: Fjalët: (libri, mbi, tavolinë)

Fjalja: Libri është mbi tavolinë.

1. (macja, nën, karrige) _____

2. (djali, mes, shokëve) _____

3. (ajo, lexon, librin, për, shkollë) _____

4. (fëmijët, luajnë, në, park) _____

5. (ai, vjen, nga, Shkupi) _____

b) Njësitë leksikore

**Fjalët dhe
shprehjet pyetëse**



Dy dhitë kryeneqe

Njëherë e një kohë, në një fshat të largët, jetonin dy dhitë shumë kokëforta. Njëra ishte e bardhë, tjetra e zezë. Të dyja njiheshin për kryeneçësinë e tyre. Një ditë, të dyja dolën për të kullotur. Rruga i çoi në një urë të ngushtë që kalonte mbi një lumë të rrëmbyeshëm. Urën e ngushtë mund ta kalonte vetëm njëra në të njejtën kohë. Dhitë u takuan përballë njëra-tjetrës në mes të urës.

- Largohu! – tha dhia e bardhë. – Unë duhet të kaloj e para.

- Jo, largohu ti! – u përgjigj dhia e zezë. – Unë nuk hap rrugë për askënd!

Asnjëra nuk pranoi të kthehej pas. Të dyja u grindën dhe filluan të shtynë njëra-tjetrën me brirë derisa ranë në lumë. Më pas, me zor dolën në breg të lodhura dhe të penduara për kryeneçësinë e tyre.



DETYRË

Lexo me kujdes këtë përrallë dhe me ndihmë të fjalëve pyetëse: *A? Çfarë? Kush? Ku? Kur? Sa? Pse? Si? Në çfarë mënyre?* formo pyetje dhe pyete shokun/shoqen e bankës, të shohësh se sa e ka kuptuar përrallën!

1. Çfarë _____
2. Kush _____
3. Ku _____
4. Kur _____
5. Sa _____
6. Pse _____
7. Si _____
8. Në çfarë mënyre _____

c) Strukturat gramatikore

Fonetika dhe drejtshqiptimi

**Shqiptimi i drejtë i
bashkëtingëlloreve**

Standardet për vlerësim:

- Shqipton drejt tingujt e gjuhës shqipe me kujdes të posaçëm për shqiptimin e bashkëtingëlloreve *dh, l, ll, rr* dhe *th*.

Disa fjalë në gjuhën shqipe përmbajnë tingujt: **dh, l, ll, rr, th** në pozicione të ndryshme (në fillim, në mes dhe në fund të fjalës). Të tilla janë:

- **dh**: dhelpër, lodhje, hudhër etj.
- **l**: libër, laps, mal etj.
- **ll**: llambë, dallgë, kallëp etj.
- **rr**: rrugë, karrige, burrë etj.
- **th**: thikë, nathë, puthje etj



AKTIVITET

Nxënësve u jepet një listë me fjalë që e përmbajnë tingujt: *dh, l, ll, rr* dhe *th* në pozicione të ndryshme. Ata nxiten të shqiptojnë saktë secilën fjalë. Më pas shkruajnë vetë disa fjalë të tilla, në mënyrë të pavarur.

Ushtrimi 1: Shqipto saktë fjalët e dhëna!

Kujdes: Lexoji me zë të lartë dhe përqendrohu te shqiptimi i tingujve:

dh: dhomë, dhuratë, lodh, dhëndër, dhëmbë.

l: librari, lule, fjalë, lojë, alfabeti.

ll: llambë, molla, dallgë, akullore, tingull.

rr: rrugë, burrë, arrë, rrotë, rreth.

th: thupra, thesi, thëllëzë, gjethe.

Ushtrimi 2: Plotëso fjalët me tingullin e duhur: *dh, l, ll, rr* ose *th*!

1. ____ambë
2. ma____
3. pu____je
4. bu____ë
5. ____ikë
6. a____ë
7. ____odhur
8. da____gë

Ushtrimi 3: Shkruaj fjalë të reja!

Nga secili tingull shkruaj të paktën 3 fjalë të tjera!

dh: _____

l: _____

ll: _____

rr: _____

th: _____

Ushtrimi 4: Rrethoni tingullin që mendoni se ishte më i vështirë për t'u shqiptuar

☐ dh ☐ l ☐ ll ☐ rr ☐ th

c) Strukturat gramatikore

Ndërrimet fonetike

Standardet për vlerësim:

- Një dukurinë e shurdhimit të bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës.

Dukuria e shurdhimit të tingujve të zëshëm në fund të fjalës



AKTIVITET

Nxënësit ndjekin një prezantim me fjali të shkurtra në të cilat përdoren fjalët që përfundojnë me një bashkëtingëllore të zëshme. (Dje shetitëm në malin Kor**ab**., Unë i vendosa paratë në xhe**p**.) Nxënësve u jepet detyrë të gjejnë fjalë që përfundojnë në një bashkëtingëllore të zëshme dhe pastaj i shqiptojnë ato. Shpjegohet se çdo bashkëtingëllore e zëshme në fund të një fjale shqiptohet ashtu si edhe bashkëtingëllorja e pa zëshme (*b-p; d-t; g-k; v-f; z-s* etj.). Në tabelë shkruhen çiftet e bashkëtingëlloreve të zëshme dhe të pa zëshme, dhe ndërkohë, nxënësve u jepet një fletë pune me një varg fjalësh, shembull: *korb-korp; kënd-kënt; zog-zok; hov-hof; oriz-oris* etj. Nxënësit, me ndihmën e mësimdhënësit/es duhet të rrethojnë fjalën e shkruar saktë dhe më pas shqiptojnë fjalët nga vargu.

Bashkëtingëllore e zëshme	Bashkëtingëllore e shurdhët	Si shkruhet saktë fjala	Si tingëllon fjala
<i>b</i>	<i>p</i>	<i>elb</i>	<i>elp</i>
<i>d</i>	<i>t</i>	<i>vend</i>	<i>vent</i>
<i>dh</i>	<i>th</i>	<i>u lodh</i>	<i>u loth</i>
<i>g</i>	<i>k</i>	<i>breg</i>	<i>brek</i>
<i>gj</i>	<i>q</i>	<i>u dogj</i>	<i>u doq</i>
<i>x</i>	<i>c</i>	<i>xixa-xixa</i>	<i>xica-xica</i>
<i>xh</i>	<i>ç</i>	<i>xhuxh</i>	<i>xhuç</i>
<i>zh</i>	<i>sh</i>	<i>ambalazh</i>	<i>ambalashh</i>
<i>v</i>	<i>f</i>	<i>negativ</i>	<i>negatif</i>
<i>z</i>	<i>s</i>	<i>njerëz</i>	<i>njerës</i>



DETYRË

Gjej dhe shkruaj 5 fjalë që ndryshe shkruhen e ndryshe tingëllojnë!

c) Strukturat gramatikore

Theksi në gjuhën standarde shqipe

Standardet për vlerësim:

- Riprodhon me theks të saktë fjalë që ka mësuar kur lexon dhe kur bisedon.

Theksi në gjuhën standarde shqipe mund të jetë fundor (*lexój*), parafundor (*shkóllë*) dhe tejfundor (*flútura*).



DETYRË

Lexo me kujdes tekstin në vazhdim dhe përpiku të lexosh me theks të saktë të fjalës dhe me intonacion të duhur!

Një mysafir në shkollën tonë

Fëmijtë e shkollës u mbledhën në oborr. Në qytét kishte ardhur një mysafir i vjetër. Ai solli me vete libra dhe lojëra për të gjithë. Nxënësit e pritën me gëzím dhe duartrokitën. Mësuesja ju tregoi fëmijëve ku do të vendoseshin në rreshta. Fëmijtë dëgjuan me vëmendje udhëzimet. Mysafiri filloi të tregojë histori për atdheun e tij. Ai përmendi tradita dhe zakone të bukura të qytetit. Pas pak, ai shpërndau libra dhe materiale mësimore për çdo fëmijë. Ata e falënderuan mysafirin për dhuratat dhe u kthyen në bankat e tyre. Në fund, të gjithë kënduan një këngë të bukur për mikun e ri. Mësuesja theksoi rëndësinë e respektit dhe mirësisë në çdo rast. Fëmijtë mësuën edhe fjalë të reja dhe praktikuan shqiptimin e tyre me theks të saktë. Ata ndanë detajet që u pëlqyen më shumë dhe dolën nga shkolla të lumtur dhe të kënaqur.



AKTIVITET

Nxënësit dëgjojnë një tekst të shkurtër me theks të saktë të fjalës dhe intonacion të përshtatshëm të fjalisë. Secili nxënës shkruan një fjalë që e ka dëgjuar dhe e lexon me zë para të gjithë klasës duke u kushtuar vëmendje intonacionit dhe theksimit të fjalëve.

PËRDITSHMËRIA IME NË MJEDISIN KU MËSOJ, KU JETOJ DHE KU SHOQËROHEM

c) Strukturat gramatikore

Morfologji

Emrat

Llojet e emrave: konkretë dhe abstraktë

Standardet për vlerësim:

- Dallon shembuj emrash konkretë dhe abstraktë.
- Ndërton fjali duke përdorur emra konkretë dhe abstraktë.

Në oborrin e shkollës, fëmijët po luanin me **top** dhe po ndanin mes tyre **buzëqeshje** dhe **gëzim**. **Lejla** mbante një **libër** në dorë dhe po tregonte me **krenari** se sa shpejt e kishte lexuar, ndërsa **Igori** me **mburrje** tregoi **vizatimin** e tij. **Mësuesi** me shumë **dashuri** përgëzoi nxënësit për sjelljen e tyre.

Fjalët e shënuara me të zezë në tekst janë **emra**.

Fjalët: **oborrin, shkollës, fëmijët, top, Lejla, libër, Igori, vizatimin, mësuesi** – janë **emra konkretë** sepse tregojnë gjëra që mund t'i shohim e t'i prekim.

Fjalët: **buzëqeshje, gëzim, krenari, mburrje, dashuri** – janë **emra abstraktë** sepse tregojnë ndjenja ose mendime që nuk mund t'i shohim e as t'i prekim.

Ushtrimi 1: Emrat: trëndafili, pikëllimi, akulli, dhimbja, uji, gëzimi, qeni, urrejtja, tavolina, liria, vendosi në kolonën e duhur!

emrat konkret	emrat abstrakt

Ushtrimi 2: Lexo fjalitë dhe nënvizo emrat konkretë, kurse rretho emrat abstraktë:

1. Nxënësi mbajti librin në dorë me shumë krenari.
2. Në oborr ishte një mollë e kuqe që i solli gëzim vajzës.
3. Shpresa për një jetë më të mirë është më e fortë se çdo telefon.
4. Ajo admiroi mençurinë e gjyshit që rrinte ulur pranë detit.

Ushtrimi 3: Lexo fjalitë dhe nënvizo emrat konkretë, kurse rretho emrat abstraktë:

1. Nxënësi mbajti librin në dorë me shumë krenari.
2. Në oborr ishte një mollë e kuqe që i solli gëzim vajzës.
3. Shpresa për një jetë më të mirë është më e fortë se çdo telefon.
4. Ajo admiroi mençurinë e gjyshit që rrinte ulur pranë detit.



DETYRË

Gjeni tre emra konkretë dhe tre emra abstraktë dhe më pas prej tyre krijoni nga një fjali!

a) Emra konkretë

(gjëra që mund t'i shohim ose t'i prekim):

b) Emra abstraktë

(ndjenja, mendime, gjendje):

Fjalitë:

c) Strukturat gramatikore

Emrat

Kategoritë gramatikore të emrit

Në gjuhën shqipe emrat kanë katër kategori:

1. Kategoria e gjinisë:

- a) gjinia mashkullore
- b) gjinia femërore
- c) gjinia asnjëanëse

2. Kategoria e numrit:

- a) numri njëjës
- b) numri shumës

3. Kategoria e trajtës:

- a) trajta e shquar
- b) trajta e pashquar

4. Kategoria e rasës:

- a) rasa emërore
- b) rasa gjinore
- c) rasa dhanore
- ç) rasa kallëzore
- d) rasa rrjedhore

Standardet për vlerësim:

- Dallon emrat sipas kategorisë gramatikore të gjinisë, të numrit, të shquarsisë dhe të rasës.
- Zbaton drejt emrat sipas kategorisë gramatikore të gjinisë, të numrit, të shquarsisë dhe të rasës në komunikimin me gojë dhe me shkrim.
- Njeh dhe dallon shprehje ku emrat janë në trajtën e shquar (të shquar).

Ushrtimi 1: Ndani këto emra sipas gjinisë:

mali, lulja, nxënësi, klasa, ditari, çanta, dielli, telefoni, dera, fletorja

Gjinia mashkullore	Gjinia femërore



DETYRË

Shkuaj dy fjali duke përdorur një emër të gjinisë mashkullore dhe një emër të gjinisë femërore

1. Gjinia mashkullore _____

2. Gjinia femërore _____

Ushrtimi 2: Nënvizdo me një vizë emrat në numrin njëjës dhe me dy viza emrat në numrin shumës!

1. Në oborr ka shumë tavolina për nxënësit.
2. Qeni i fqinjit po luante me qentë në park.
3. Në raft ka një libër të ri dhe disa libra të vjetër.
4. Në kopsht rritet një lule e bukur dhe disa lule të tjera janë ngjitur pranë saj.
5. Një kodër e lartë duket nga larg, por ka edhe disa kodra më të vogla .



DETYRË

Shkuaj shumësin e emrave në vazhdim!

Emri në numrin njëjës

1. Laps
2. Vajzë
3. Mal
4. Zog
5. Bujk
6. Lepur
7. Djalë
8. Mulli

Emri në numrin shumës

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____

Ushrtimi 3: Lexo fjalitë dhe nënvizdo emrin në trajtën e pashquar, ndërsa rretho emrin në trajtën e shquar

1. Në klasë ka një **nxënës** të ri. **Nxënësi** është shumë i sjellshëm.
2. Në oborr ndodhet një **pemë**. **Pema** është e mbushur me mollë.
3. Në dritare është një **lule** e kuqe. **Lulja** i pëlqeu Anës.
4. Darisi bleu një **pikturë**. **Piktura** ishte e bukur.



DETYRË

Në fjalitë në vijim, vendos në klapa emra në trajtën e duhur (të shquar ose të pashquar)!

1. Në klasë ka shumë (_____).
2. Sot lexova një (_____).
3. (_____) është i kaltër.
4. Një (_____) këndonte në degë.
5. (_____) kishte çelur në vazo.

Ushrtimi 4: Vëzhgo me kujdes lakimin në rasa të emrit *djali*, në trajtën e shquar dhe në trajtën e pashquar dhe përpiku të lakosh vetë emrin *vajza*, po në të dy trajtat!

Rasa	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
Emërore	<i>(një) djalë</i>	<i>djali</i>
Gjinore	<i>i, e (një) djali</i>	<i>i, e djalit</i>
Dhanore	<i>(një) djali</i>	<i>djalit</i>
Kallëzore	<i>(një) djalë</i>	<i>djalin</i>
Rrjedhore	<i>prej (një) djali</i>	<i>prej djalit</i>

Rasa	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
Emërore	<i>(një) vajzë</i>	
Gjinore		
Dhanore		
Kallëzore		
Rrjedhore		

c) Strukturat gramatikore

Emrat

Formimi i shumësit tek emrat

Standardet për vlerësim:

- Dallon mënyrën e formimit të shumësit me prapashtesa dhe me ndërrim tingujsh.

a) Disa emra në gjuhën shqipe, kanë formë të njejtë, si në numrin njëjës ashtu edhe në numrin shumës, që do të thotë se nuk ndyshojnë temën. Për shembull:

Përpiqu, me ndihmën e mësimitdhënësit, të gjesh shumësin e këtyre emrave:

- (një) nxënës; (disa) nxënës
- (një) mësues; (disa) _____
- (një) qen; (disa) _____
- (një) muaj; (disa) _____
- (një) mace; (disa) _____
- (një) shoqe; (disa) _____

b) Disa emra të tjerë shumësin e formojnë me prapashtesa. Për shembull:

Përpiqu, me ndihmën e mësimitdhënësit, të gjesh shumësin e këtyre emrave:

- (një) dyqan; (disa) dyqane
- (një) arsimtar; (disa) _____
- (një) shkollë; (disa) _____
- (një) vajzë; (disa) _____
- (një) gjë; (disa) _____

c) por ka edhe emra të tillë, që shumësin e formojnë me ndërrime tingujsh. Për shembull:

Përpiqu, me ndihmën e mësimitdhënësit, të gjesh shumësin e këtyre emrave:

- (një) mik; (disa) miq
- (një) zog; (disa) _____
- (një) lepur; (disa) _____
- (një) natë; (disa) _____
- (një) dash; (disa) _____
- (një) treg; (disa) _____



AKTIVITET

Nxënësit ndahen në grupe, secilit grupi i jepet një listë me emra. Ata duhet t'i thonë ata duke i ndryshuar sipas: gjinisë, numrit dhe trajtës. Më pas hartojnë fjali të shkurtra, i shkruajnë në tabelë dhe i kontrollojnë a janë të sakta.

c) Strukturat gramatikore

Mbiemrat

Klasifikimi i mbiemrave

Standardet për vlerësim:

- Njeh llojet e mbiemrave sipas kuptimit dhe sipas veçorive morfologjike.

Mbiemrat klasifikohen sipas dy kritereve:

- 1) Sipas kuptimit të tyre leksikor
- 2) Sipas veçorive të tyre morfologjike.

1) Sipas kuptimit të tyre leksikor, kemi mbiemra:

a) mbiemra cilësorë – që emërtojnë veti a cilësi që kapen drejtpërsëdrejti me shqisa, si p.sh:

- ngjyrë: *i bardhë, i zi, i verdhë* etj.
- shtrirje hapsinore, madhësi, formë: *i gjatë, i gjerë, i hollë, i thellë* etj.
- shije: *i ëmbël, i hidhur, i shijshëm* etj.
- veti fizike a gjendje shpirtërore: *i butë, i çalë, i fortë, i verbër* etj.

b) mbiemra marrëdhëniorë -që japin tiparin e sendit nëpërmjet emërimit të marrëdhënieve të këtij sendi me një send tjetër, me një rrethanë apo me një veprim, si p.sh:

- *shall i leshtë, buzëqeshje fëmije, shtyllë e mermertë, qumësht lope, derë e hekurt, fustan i*

2) Sipas veçorive të tyre morfologjike, kemi mbiemra:

a) të nyjshëm dhe

b) të panyjshëm

Ushrtimi 1: Në fjalitë më poshtë, nënvizo mbiemrat dhe trego llojin e tyre (cilësor apo marrëdhëniorë)

1. Fikreti dhe Filipi zbukurojnë oborrin e shkollës së re. (_____)
2. Fustani i mëndafshtë i rrinte shumë bukur Anës. (_____)
3. Viti i parë kaloi shumë shpejt. (_____)
4. Lapsi i kuq kishte humbur në dhomën Erminis. (_____)
5. Fshehtësia i tregohet shokut besnik. (_____)
6. Sot dita agoi me një diell pranveror. (_____)

Ushrtimi 2: Lidh me shigjetë emrin me mbiemrin e duhur!

kopsht	krahëshkruar
flutur	e zgjuar
porta	i lartë
këpucë	të ngushta
mal	shumëngjyrësh
zogj	e hekurt
vajzë	shtegtarë



AKTIVITET

Nxënësit luajnë lojë të llojit *"gjeje gabimin"*. Ata tërheqin fleta të vogla pune, të përgatitura më parë nga mësimmhënësi/ja ku janë shënuar gabim emrat në përshtatje me mbiemrat (p.sh: *qen besnike, kotele dembel, kalë të bukur, bletë punëtor etj*), e lexojnë dhe pastaj e korrigjojnë atë.

c) Strukturat gramatikore

Përemrat



AKTIVITET

Nxënësit në çifte simulojnë një bisedë duke përdorur në mënyrë të përshtatshme përemrat vetorë. Shembull: *A ke ti dhomën tënde të veçantë? Ne jemi gjithmonë të parët në gara. Ai ta jep gjithmonë biçikletën. Unë konkurroj për shkollën tonë në çiklizëm.*

Ushtrimi 1. Njohja dhe dallimi

Shkruaj në kolonën e duhur përemrat e dhënë: **vetorë** ose **dëftorë**!

Përemri	Vetor	Dëftor
unë		
ti		
ai		
ne		
ju		
ata		
ajo		
këta		
ky		

Standardet për vlerësim:

- Njeh dhe dallon sipas vetës, gjinisë dhe numrit përemrat vetorë, trajtat e përemrave vetorë dhe përemrat dëftorë në komunikimin me gojë dhe me shkrim.
- Identifikon dhe përdor trajtat e përemrit vetvetor në situata të ndryshme të të folurit.

Ushtrimi 2. Identifikimi sipas vetës, gjinisë dhe numrit

Shkruaj **vetën**, **gjininë** dhe **numrin** për çdo përemër vetor:

Përemri	Veta	Gjinia	Numri
unë			
ti			
ai			
ajo			
ne			
ju			
ata			
ato			

Ushtrimi 3. Plotëso fjalitë

Përdor përemrat e mësuar për të plotësuar vendet e zbrazëta!

1. _____ shkova në shkollë me shokët e mi.
2. _____ e pëlqeu librin e ri që mori.
3. _____ fëmijët luajtën në oborr me top.
4. A e ke parë _____ sot në klasë?
5. _____ do të vizitojmë muzeun javën e ardhshme.



DETYRË

Gjej dhe nënvizo përemrat vetvetorë në tekst dhe më pas përdori ato për të krijuar 3 fjali të reja!

Maja është një vajzë e kujdesshme. Ajo gjithmonë kujdeset për veten dhe punon me përkushtim. Kur gjen kohë të lirë, shpesh flet me vete dhe mendon për ëndrrat që ka. Ndonjëherë, ajo i thotë shoqes së saj: “Duhet të besosh tek vetja, sepse askush nuk mund ta bëjë këtë më mirë se ti”

1. _____
2. _____
3. _____

c) Strukturat

Foljet

Mënyra dëftore

- *Koha e tashme:*

- | | |
|-----------------|--------------------|
| 1. unë shkoj | 1. ne shkojmë |
| 2. ti shkon | 2. ju shkoni |
| 3. ai/ajo shkon | 3. ata/ato shkojnë |

- *Koha e pakryer:*

- | | |
|-------------------|--------------------|
| 1. unë shkoja | 1. ne shkonim |
| 2. ti shkoje | 2. ju shkonit |
| 3. ai/ajo shkonte | 3. ata/ato shkonin |

- *Koha e kryer e thjeshtë:*

- | | |
|-----------------|-------------------|
| 1. unë shkova | 1. ne shkuam |
| 2. ti shkove | 2. ju shkuat |
| 3. ai/ajo shkoi | 3. ata/ato shkuan |

- *Koha e ardhme:*

- | | |
|------------------------|--------------------------|
| 1. unë do të shkoj | 1. ne do të shkojmë |
| 2. ti do të shkosh | 2. ju do të shkoni |
| 3. ai/ajo do të shkojë | 3. ata/ato do të shkojnë |

Standardet për vlerësim:

- Dallon foljet sipas kategorive gramatikore të mënyrës, të vetës, të numrit dhe të kohës dhe i përdor drejt.
- Dallon kohën e pakryer dhe kohën e kryer të thjeshtë të foljes dhe i përdor ato drejt.
- Njeh trajtat e foljeve që shprehin kohën e ardhme.
- Njeh dhe krahason format e kohës së tashme me ato të së pakryerës dhe të së kryerës së thjeshtë në mënyrën dëftore.



DETYRË

Zgjedho në mënyrë të njëjtë edhe foljet: *laj, punoj, gatuj!*

Ushtrimi 1. Shkruaj foljen *vallëzoj*, në vetën e parë, njëjës!

- a. në kohën e tashme: _____
- b. në kohën e pakryer: _____
- c. në kohën e kryer të thjeshtë: _____
- ç. në kohën e ardhme: _____

Ushtrimi 2. Shkruaj fjali duke përdorur foljen *luaj*, në vetën e dytë, shumës!

1. në kohën e tashme: _____
2. në kohën e pakryer: _____
3. në kohën e kryer të thjeshtë: _____
4. në kohën e ardhme: _____

c) Strukturat gramatikore

Foljet

Mënyra lidhore

- *Koha e tashme:*

- | | |
|---------------------|-----------------------|
| 1. unë të shkoj | 1. ne të shkojmë |
| 2. ti të shkosh | 2. ju të shkoni |
| 3. ai/ajo të shkojë | 3. ata/ato të shkojnë |

Mënyra dëshirore

- *Koha e tashme:*

- | | |
|-------------------|---------------------|
| 1. unë shkofta | 1. ne shkoftim |
| 2. ti shkoft | 2. ju shkofti |
| 3. ai/ajo shkoftë | 3. ata/ato shkoftin |

Standardet për vlerësim:

- Shënon foljet në kohën e tashme në mënyrën dëftore, lidhore dhe dëshirore.
- Njeh dhe dallon format e mënyrës dëftore, lidhore dhe dëshirore në kohën e tashme.



DETYRË

Zgjedho në mënyrë të njejtë edhe foljet: *laj, punoj, gatuj!*

Ushtrimi 1. Shkruaj foljen *dal*, në kohën e tashme, në vetën e tretë, njëjës!

a. në mënyrën lidhore: _____

b. në mënyrën dëshirore: _____

Ushtrimi 2. Shkruaj fjali duke përdorur foljen *shkruaj*, në vetën e parë, shumës!

1. në mënyrën lidhore: _____

2. në mënyrën dëshirore: _____



AKTIVITET

Nxënësit dëgjojnë tekste të shkurtra. Vetë nxënësve duhet të dallojnë fjalitë se kur veprimi është i shprehur në kohën e tashme, në të shkuarën: në të pakryerën dhe në të kryerën e thjeshtë apo në të ardhmen dhe të njejtat i shkruajnë në një fletë. Më pas punojnë në grupe të vogla ku secilit grupi i jepet një fletë pune ku duhet t`i ndyshojë foljet nga një kohë në një kohë tjetër.

c) Strukturat gramatikore

**Lidhëzat dhe
parafjalët**

Standardet për vlerësim:

- Dallon lidhëzat dhe parafjalët në raport me pjesët e tjera të ligjëratës gjatë përdorimit të tyre në fjali.

Lidhëzat janë fjalë të pandryshueshme që shërbejnë për të lidhur fjalë, grupe fjalësh ose fjali midis tyre, të tilla janë: *dhe, edhe, ose, kurse, po, por, apo, as, kurse, mirëpo, ndërsa, prandaj, sepse, meqenëse etj.*

Parafjalët janë fjalë ose shprehje, gjithashtu të pandryshueshme të ligjëratës, që shprehin marrëdhënie varësie ndërmjet fjalëve. Parafjalët vendosen para një emri, përemri, numërori apo para një ndajfoljeje, të tilla janë: *në, nën, mbi, nga, te, tek, për, prej, përmbi, nëpër, mes, ndaj etj*



DETYRË

Lexo me kujdes fjalitë në vazhdim! Vëre fjalët e shënuara me të zezë dhe dallo cilët janë **lidhësa**, e cilët janë **parafjalë**!

- Unë shkova në park **dhe** takova shokun tim. _____
- Sapo u ktheva **nga** shkolla. _____
- Ne shkuam në bibliotekë, **ndërsa** ata mbetën në shtëpi.
- Fola me entuziazëm, **por** askush nuk më dëgjoi. _____
- Shumë **prej** nesh gjatë kohës së pushimit kemi mësuar. _____
- Ajo nuk erdhi në shkollë, **sepse** ishte e sëmurë. _____
- Vajzat ishin në teatër, **kurse** djemtë po luanin futboll. _____
- Babai edhe **tek** unë me një dhuratë të bukur. _____
- Sot mësuesja më qorto, **sepse** nuk kisha mësuar fare. _____
- Motra u lëndua, **prandaj** e dërguan te mjeku. _____



AKTIVITET

Nxënësve u jepet një listë e shkurtër me lidhësa. Për secilën lidhëz ata shkruajnë fjali dhe më pas kontrollojnë njëri-tjetrin për gabimet eventuale.

c) Strukturat gramatikore

Sintaksa

Fjalë e thjeshtë

Standardet për vlerësim:

- Përdor drejt në fjali togfjalëshat e ndërtuar nga një emër dhe një mbiemër.
- Ndërton fjali dhe identifikon renditjen e drejtë dhe jo të drejtë të fjalëve në një fjali të thjeshtë.

Çfarë është togfjalëshi?

Togfjalëshi është njësia sintaksore strukturore e përfshirë gjatë ligjërimit nga bashkimi gramatikor dhe kuptimor i dy ose më shumë fjalëve kuptimplota, që tregojnë marrëdhënie midis sendeve, dukurive, proceseve e tipareve.

Fjalët që mund të bashkohen dhe që formojnë togfjalësha, janë emrat, mbiemrat, përemrat, numërorët, foljet, ndajfoljet.

Për shembull: Fjalitë e shënuara me të zeza janë togfjalësha (emër + mbiemër)

1. Fëmija bleu **karamela të ëmbla**.
2. Ne pamë **një histori magjike** në televizor.
3. Ata vendosën **qilim shumëngjyrësh** në dhomë.
4. Mësuesja vizatoi **shtëpi të bardhë** në fletore.
5. Ai solli **libër të vjetër** nga shtëpia.

Ushtrimi 1: Lexo fjalitë dhe nënvizo togfjalëshat!

1. Në kopsht lulëzuan lulet shumëngjyrëshe.
2. Mësuesi lexoi një libër interesant.
3. Mami gatuan gjellë të shijshme.
4. Filloi të binte shi i rrëmbyer.
5. Të gjithë kishin blerë çanta të reja.

Ushtrimi 2: Përdor togfjalëshat e dhënë për të krijuar fjali të thjeshta!

1. shtëpi e madhe _____
2. vajzë e zgjuar _____
3. fëmijë i lumtur _____
4. shkollë e re _____
5. deti i kaltër _____



DETYRË

Në fjalitë më poshtë, bëni renditjen e drejtë të fjalëve!

1. lundron luginë mbi Një mjegull e bardhë

2. e harro mikun e vjetër Mos

3. trëndafil të kuq një më kërkoi Ajo

4. bibliotekën e madhe vizituan Djemtë


5. punëtor djal Beni ishte



AKTIVITET

Nxënëve u jepen disa fjali që kanë radhitje të saktë të fjalëve në fjali dhe disa të tjera me radhitje të pasaktë të fjalëve. Shënojnë me shenjën ✓, rendin e saktë të fjalëve dhe komentojnë duke i korrigjuar të gabuarat.

Dëgjimi dhe leximi i teksteve të shkurtra



Standardet për vlerësim:

- Lexon me shqiptim të saktë të tingujve, theksim të saktë të fjalës dhe intonacion të saktë të fjalisë.
- Dëgjon dhe lexon fjalë të reja, dialogë dhe tekste të shkurtra.
- Dëgjon, lexon dhe u përgjigjet pyetjeve të synuara që lidhen me dialogë dhe tekste të shkurtra.
- Shkruan një dialog të shkurtër.

Një ditë në shkollën tonë

Në shkollën tonë dita fillon gjithmonë me tingullin e këmbanës. Nxënësit hyjnë në klasë dhe përshëndesin mësuesen. Pas orës së parë, gjatë pushimit, disa nxënës filluan tëbisedojnë për detyrat dhe aktivitetet që i prisnin gjatë ditës.

Ola: A e bëtë detyrën e matematikës? Ishte pak i vështirë ushtrimi i fundit.

Iliri: Po, e bëra. M'u desh shumë kohë, po ia dola. Nëse do, mund ta shpjegojmë bashkë.

Dafina: Shumë mire, se edhe unë kam disa pyetje. Në fund të fundit, bashkë mësojmë më lehtë. Mësuesja hyri në klasë dhe filloi orën e matematikës. Ola, Iliri dhe Dafina e zgjidhën shpejtë detyrën sepse kishin ushtruar së bashku. Pas saj, ata kishin orën e gjuhës Shqipe. Nxënësit lexuan një tregim dhe diskutuan mbi personazhet.

Mësuesja: Kush mendoni se ishte personazhi më i guximshëm në këtë tregim?

Ola: Sipas meje, ishte vajza që ndihmoi shokun e saj, sepse tregoi guxim dhe dashamirësi.

Iliri: Unë mendoj ndryshe. Për mua ishte djaloshi që nuk u dorëzua edhe kur hasi vështirësi. Mësuesja buzëqeshi dhe tha se të dyja përgjigjet ishin të drejta, sepse secili e sheh tregimin me sytë e vet.

Pas mësimave, nxënësit dolën në oborrin e shkollës për aktivitetet jashtëmësimore. Një grup u mbledh në sallën e sportit për të luajtur basketboll, ndërsa një tjetër shkoi në kabinetin e artit për të vizatuar.

Dafina: Ej Ola, do vish me ne në pikturë? Sot do të bëjmë një poster për mbrojtjen e mjedisit.

Ola: Do të vij pak më vonë. Fillimisht dua të luaj një ndeshje basketbolli me Ilirin.

Iliri: Po, le të shohim kush fiton!

Më vonë kur u mbledhën të gjithë në kabinetin e artit, secili solli idetë e veta.

Dafina: Unë do të vizatoj një pyll të gjelbër.

Ola: Unë mund të vizatoj fëmijë që mbjellin pemë.

Iliri: Atëherë unë do të shkruaj një slogan: “Mburo mjedisin, mburo të ardhmen!”

Kur posteri u përfundua, të gjithë ndiheshin krenarë për punën e përbashkët.

Në fund të ditës, para se të ktheheshin në shtëpi, nxënësit u ulën nën hijen e një peme në oborr dhe biseduan.

Dafina: Më pëlqeu shumë kjo ditë. Mësuam, u argëtuam dhe bëmë diçka të dobishme.

Ola: Po, Shkolla nuk është vetëm detyra e libra, por edhe bashkëpunim dhe miqësi.

Iliri: E vërtetë. Nëse çdo ditë do të ishte kështu, Shkolla do të ishte edhe më e bukur.

Ata qeshën dhe u nisën drejt shtëpive, duke e ditur se të nesërmen i priste një ditë e re me plot mundësi.



DETYRË

Lexo tregimin me kujdes dhe përgjigju pyetjeve:

- Si fillon dita në shkollë e nxënësve?
- Cila lëndë ishte e para në orar?
- Për çfarë tregimi biseduan nxënësit në orën e gjuhës shqipe?
- Sipas Olës, kush ishte personazhi më i guximshëm në tregim?
- Çfarë mendonte Iliri për personazhin më të guximshëm?
- Çfarë aktivitete jashtëmësimore u zhvilluan pas mësimi?
- Çfarë posteri vendosën të përgatisnin nxënësit në kabinetin e artit?
- Cilin slogan e shkroi Iliri në poster?
- Çfarë kuptuan nxënësit në fund të ditës për shkollën?
- Cila pjesë e tregimit të pëlqeu më shumë dhe pse?



AKTIVITET

Nxënësit të ndarë në grupe, gjejnë fjalët e reja në tekstin e dhënë dhe i shkruajnë në dërrasë. Me ndihmën e mësimdhënësit/es i lexojnë me shqiptim, theks dhe intonacion të saktë. Pastaj secili nga grupet zgjedh disa fjalë të reja që më parë i shkruajtën në dërrasë, dhe krijojnë nga një dialog të shkurtër. Në fund, secili grup lexon dialogun para të tjerëve në klasë.

Të shkruarit



DETYRË

Radhitni fjalët e shënuara më poshtë, duke përdorur drejtë rendin e fjalëve në fjali.

Shembull:

- është, sepse, shumë, Shkolla, e dua, e imja, unë, vetëm.
Shkolla është vetëm e imja sepse unë e dua shumë.
- ndaj, mësuesve, tepër, Respekti, është, i rëndësishëm.

- Bindja, rregullave, më të sigurt, të shkollës, e bën, ndaj, mjedisin, për të gjithë.

- shpesh, konflikte, ndaj, Mosrespekti, sjell, keqkuptime, dhe, të tjerëve.

- Sinqeriteti, është, vlerat, që na ndihmon, një nga, miqësi, të kemi, të qëndrueshme.

- nxënës, Një, fiton, i besueshëm, vlerësimin, gjithmonë, e shokëve.

Standardet për vlerësim:

- Shkruan një tekst të lidhur (5-6 fjali) me rendin e drejtë të gjymtyrëve të fjalisë.
- Përdor drejt shkronjën e madhe kur shkruan emrat, mbiemrat dhe pseudonimet (nofkat), emrat e institucioneve, emrat e botës mitologjike e fetare, emërtimet gjeografike (edhe të një emri vendi prej dy a më shumë fjalësh), emërtimeve të festave kombëtare e ndërkombëtare etj.
- Përdor saktë pikën, pikëpyetjen, pikëçuditjen, presjen, dy pikat, shumëpikëshin, kur shkruan me diktim ose në mënyrë të pavarur.



DETYRË

Në tekstin më poshtë, vendosni shkronjën e madhe aty ku është e nevojshme, në përputhje me rregullat për përdorimit e shkronjave të mëdha!

Unë jam në mavrovë gati çdo javë me prindërit dhe me vëllain tim lulin. nesër do të vijë edhe violeta nga gjermania për ta festuar bashkë 8 marsin, festën e nënës. ajo ka shumë miq në maqedoninë e veriut. vjet më uroi me kartolinë kur mora çmimin e parë për poezinë më të mirë në konkursin e organizuar nga ministria e arsimit dhe shkencës. edhe unë do t'ja uroj ditëlindjen me një dhuratë të bukur.



AKTIVITET

Nxënësit shkruajnë një diktimi të lexuar nga mësimdhënësi. Më pas ndahen në dyshe dhe e kontrollojnë të njeitin nëpërmjet tekstit që mësimdhënësi shkruan në tabelë për përdorimin e saktë të pikës, të pikëpyetjes, të pikëçuditjes, të presjes, tri pikave dhe shenjave të tjera të pikësimit.

d) Tema për diskutim

Respekti për të gjithë në shkollë, edhe ndaj atyre që ndryshojnë nga ne



AKTIVITET

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth dhe duhet të tregojnë pse e respektojnë njëri-tjetrin. Një nxënës fillon, duke u kthyer nga nxënësi në të djathtë të tij dhe duke thënë: “*Respekt për* (emrin e shokut/shoqes e klasës) *sepse* (tregon tiparin ose sjelljen e shokut/shoqes në fjalë). Nxënësi të cilit i drejtohet respekti falënderon dhe i kthehet nxënësit/es tjetër në të djathtë dhe vazhdon me të njëjtën fjali e kështu me radhë deri sa të arrijë te nxënësi që ka filluar i pari.

Diskutoni së bashku:

- Çfarë përfitimesh mendoni se kemi kur mësojmë dhe shoqërohemi me nxënës nga komunitete të ndryshme?
- Si ndihmon shkolla që nxënësit të njohin më mirë kulturat dhe traditat e njëri-tjetrit?
- A ka ndonjë shembull nga jeta juaj kur keni mësuar diçka të re nga një shok ose shoqe që vjen nga një komunitet tjetër?
- Cilat janë disa ngjashmëri që i keni vënë re mes komuniteteve të ndryshme?
- Po dallimet? Si mund t’i pranojmë dhe t’i respektojmë ato?
- Si mund të ndikojë shoqërimi me komunitete të ndryshme në të ardhmen tonë?
- Çfarë ndodh kur nuk pranojmë dhe nuk respektojmë kulturën apo traditën e dikujt tjetër?
- Si mund ta bëjmë klasën dhe shkollën tonë një vend ku secili ndjehet i pranuar dhe i barabartë?
- Po në lagjen tuaj? Shoqëroheni me fëmijë që janë ndryshe nga ju?
- Si e shprehni respektin për ta?

Standardet për vlerësim:

- Tregon karakteristikat lidhur me funksionimin e shkollës së vet (vlerat, tradita, klima në shkollë, mundësitë, toleranca ndaj dallimeve, bashkëpunimi, komunikimi etj.) në raport me shkollat e tjera.
- Tregon përfitimet e të jetuarit, të mësuarit dhe shoqërimit me komunitete të ndryshme etnike në shkollën e vet ose me nxënës të tjerë nga një shkollë tjetër.
- Dëgjon, kupton dhe u përgjigjet pyetjeve/informatave që kanë të bëjnë me ngjashmëritë dhe dallimet e nxënësve në sjellje, në të mësuar dhe në shoqërim.

d) Tema për diskutim

Ndërkombëtarizmat dhe ballkanizmat

Standardet për vlerësim:

- Prezanton fjalë që janë të ngjashme ose të ndryshme në aspektin e shqiptimit në gjuhët ballkanike.

A e ke ditur se:

Ndërkombëtarizmat janë fjalë që përdoren në shumë gjuhë të botës. Shpesh kanë orgjinë nga latinishtja ose greqishtja e vjetër. Kanë të njejtin të kuptim dhe formë të ngjashme në gjuhë të ndryshme. Përhapen sidomos përmes shkencës, teknologjisë apo kulturës.

Ballkanizmat janë fjalë ose dukuri gjuhësore që përdoren kryesisht në gjuhët e Ballkanit. Janë rezultat i jetesës së përbashkët, kontakteve kulturore dhe historike. Përdoren në disa gjuhë të rajonit me kuptime dhe forma të ngjashme. Shpesh kanë orgjinë Shqipe, turke, slave apo greke.

Ushtrim:

Lexo dhe shqipto në gjuhën shqipe	Shkruaj dhe shqipto në gjuhën tënde amtare
telefon	
universitet	
muzikë	
matematikë	
pazar	
çorap	
çokolladë	
hotel	
çorbë	



AKTIVITET

Nxënësit të ndarë në grupe, kanë për detyrë të bëjnë kërkime dhe të paraqsin një listë me sa më shumë fjalë të jetë e mundur, që kanë kuptim dhe shqiptim të ngjashëm në gjuhët që fliten në Ballkan. Prezantimet e suksesshme ndahen në një vend të përshtatshëm në klasë.